




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [gëgjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

I mbajtur në Seancën inauguruese të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 24.12. 2013 me këtë:

RENDI TË PUNËS

10:00-10:15	Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë
10:15-10:30	Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës, <ul style="list-style-type: none">• Fjala mirëseardhëse,
10:30-10:45	Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës, <ul style="list-style-type: none">• Dhënia e Betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës,• Dhënia e Betimit të Kryetarit të Komunës,
10:45-11:00	Fjala përshendetëse e Kryetarit të Komunës, z. Lutfi Haziri
11:00	Mbyllja e seancës

Në seancën inauguruese të Kuvendit të Komunës së Gjilanit morën pjesë, anëtarët e rinj të Kuvendit, kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri, institucionet komunale dhe shtetërore të Kosovës si: Përfaqësuesi i Prokurorisë së Shtetit, përfaqësuesi i Gjykatës Themelore në Gjilan përfaqësuesit e Policisë Regjionale dhe Komunale, përfaqësuesit e FSK-së, Organizata e dala nga lufta, përfaqësuesit e MPL-së, deputetja e Kuvendit të Kosovës, zonja Lirie Kajtazi, akademik Mehmet Halimi, Qytetar Nderi i Komunës së Gjilanit

shoqatat dhe OJQ, të e ndryshme që veprojnë në Gjilan dhe Kosovë, por edhe institucionet ndërkombëtare si OSB etj, si dhe mediet e shkruara dhe elektronike.

Seancën inauguruese e hapi dhe udhëhoqi anëtari më i vjetër i Kuvendit, z. Zijadin Maliqi i cili fillimisht kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të rinj të Kuvendit, në këtë seancë inauguruese.

Nga ana e sekretarisë e Konstatua se në këtë seancë ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit (35).

Në vijim të fjalës së tij z. Maliqi theksoi se të gjitha kushtet janë të plotësuara për të vazhduar me punë dhe në bazë të nenit 42- 03/ L/ 040 të LVL-së këtë seancë e thërret kryetari i Komunës, kurse mbledhja kryesohet nga anëtari më i vjetër i Kuvendit e që jam unë Zijadin Maliqi.

Fillimisht iu përshëndes juve të nderuar anëtarë të Kuvendit, kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, por të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët u theksuan më lartë.

Rendi i punës është unik për të gjitha komunat e Kosovës, prandaj të nderuar anëtarë të Kuvendit këtë rend e keni marrë me kohë, prandaj po fillojmë me procedim të rendit të punës.

1. Dhënia e betimit e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit ngritën në këmbë, kurse kryesuesi e lexon tekstin e betimit, të cilin tekst e posedojnë të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe e japin betimin gojarisht, kurse betimi me nënshkrimet e tyre i dorëzohet sekretarisë së Kuvendit.

Pas dhënies së betimit, kryesi i përshëndet të gjithë anëtarët e Kuvendit duke i uruar suksese dhe punë të mbarë gjatë këtij mandati qeverisës.

2. Dhënia e betimit të kryetarit të Komunës, z. Lutfi Haziri

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri, del para foltores dhe jep betimin si pas ligjit të LVL-së pas të cilit betim, pasojnë duartrokitjet e të pranishmëve në sallë.

3. Fjala përshëndetëse e kryetarit të Komunës

Në fjalën përshëndetëse kryetari Komunës theksoi se ju të nderuar anëtarë të zgjedhur të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, deputet, anëtarë, kryetar të degëve të partive politike, kryetar dhe anëtarë të Shoqatave të dala nga lufta, familje të dëshmorëve, institucione të shteti si Policia, Gjyqësori, Prokuroria e Shtetit, zonja dhe zotëri dhe i nderuari akademik Mehmet Halimi, Qytetar Nderi i Komunës sonë më lejoni që në këtë ditë të shënuar për Komunën tonë t'iu përshëndes dhe në radhë të parë t'iu uroj suksese anëtarëve të rinj të Kuvendit të Komunës të zgjedhur me votën e popullit dhe që morët besimin e qytetarëve të Komunës, ju jeni ata që paraqitini, mbronni dhe angazhoheni që Komuna e jonë të jetë një vend i dëshiruar për të jetuar, për të punuar dhe për të mbajtur familjet e tyre.

Besoj shumë që si kryetar i Komunës do ta kthejmë dhe fuqizojmë rolin e KK-së në ushtrimin e të gjitha detyrave ligjore pa dallim partiak, pa dallime ideologjike dhe pa dallime të tjera që mund ta përshkruajnë vazhdimisht një seancë, një Kuvend, apo një organ i cili pasqyron multipartizmin dhe përfaqësimin multipartiak si çdo kund.

Demokracia është e tillë dhe fal saj ne do të angazhohemi që me debate, me angazhime konkrete dhe me angazhimin e të gjithëve nesër jo vetëm këshilltarëve komunal, por edhe shoqërisë civile dhe grupeve të interesave, Komuna e jonë të nxjerr vendime meritore dhe të sjell vendime të drejta në mënyrë që vendi ynë, qyteti i jonë, lagjet tona dhe fshatrat tona nesër të jenë më të zhvilluara.

Ne më shumë se kurrë kemi nevojë që kërkesat e qytetarëve tanë të jenë në rritje e sipër dhe dëshira e tyre në ofrimin e shërbimeve publike dhe shërbimeve tjera të jenë sa më cilësore. Do të vazhdojmë për ta përmirësuar ambientin e qytetit të Gjilanit si qytet lider regional në rritjen e bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre dhe promovimin e të rejave.

I uroj punë të dinjitetshme drejtorëve të rinj, duke iu ofruar kushte kualitative bashkëkohore. Do të angazhohemi për sigurimin e një buxheti të balancuar dhe një disiplinë të rrebet buxhetore, një disiplinë disiplinore për të cilën kjo Komunë ka nevojë për t' i shlyer të gjitha obligimet e saja dhe për të fituar besim nga donatorët dhe organizatat e tjera të cilat mund të vijnë nesër dhe të na mbështesin dhe të jenë bashkëpjesëmarrës në zhvillimin tonë. Në vijim të fjalës së tij kryetari i sqaroi edhe disa segmente lidhur me zhvillimin e Komunës siç ishin kushtet më të mira të jetesës për gjithë qytetarët, sigurinë e tyre.

Ia kem për borxh atyre që sakrifikuan për lirinë që po e gëzojmë, të kemi kujdesin më të madh për familjet e tyre, por një kujdes të veçantë do ta kemi për dëshmorët dhe familjet e tyre.

Gjilani ka nevojë për një unitet i cili siguron angazhim të të gjithëve.

Unë iu ftoj që nga sot të punojmë bashkë, sepse nesër edhe shërbimet edhe administrata edhe ekzekutivi dhe shërbyesit civil dhe shërbyesit publik janë ata që kanë vetëm një detyrë e ajo është t' iu shërbejnë qytetarëve të Komunës.

Unë iu siguroj se do të jem i paanshëm dhe i barabartë me të gjithë duke larguar çdo tendencë tjetër, por duke garantuar që Komuna jonë do të punojë në frymën e sundimit të ligjit, në frymën e funksionimit të institucioneve të shtetit, në frymën e luftës kundër çdo lloj krimi, korrupsioni dhe papastërtie që ata që kanë dëshiruar dhe ata që mund ta shfrytëzojnë këtë vakum kanë realizuar qëllime të vogla. Qëllime të vogla, por që kanë dëmtuar jetën e qytetarit tonë. Do të jemi të paanshëm në realizimin e objektivave për një vizion që Gjilani të jetë një qendër regjionale, qendër e zhvilluar ekonomike dhe qendër edukativo-arsimore.

Zonja e zotërinj, kjo ditë shënon një kthesë të vogël në tranzicionin e pushtetit në Komunën tonë dhe në këtë rast Gjilani dëshmoi se tranzicioni është pjesë e kulturës sonë politike. Unë e falënderoj kryetarin e deritashëm i cili e ka kryer detyrën për përpjekjet e tij, për angazhimet e tij, falënderoj edhe Degën e PDK-së, anëtarët që kanë qeverisur këto 6 vjet dhe të gjithë anëtarët e KK-së duke qenë opozitë deri dje, sepse kanë bërë përpjekje dhe janë angazhuar që t' i realizojnë synimet e tyre. Mirëpo ashtu siç u deklaruar populli më 3 nëntor me votë të lirë, ashtu drejt po bëhet edhe ky tranzicion i cili tregon kulturën politike të Gjilanit dhe Anamoravës.

Ju përshëndes dhe punë të mbarë për këto katër vite.

Me falën përshëndetëse të kryetarit seanca inauguruese e Kuvendit përfundoi.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Zijadin MALIQI